



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1669/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS–Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit BPrAL “Kolegji UBT-e” Sh.p.k me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Y.B. dhe A.T., kundër të paditurës Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura Shtetërore, dhe Agjencia e Akreditimit të Kosovës me seli në Prishtinë të përfaqësuar nga Avikatura Shtetërore dhe Sadik Bytyqi, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjyqimit të Gjykatës Komerciale–Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.156/22, të datës 02.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit BPrAL “Kolegji UBT-e” ShPK me seli në Prishtinë, e datës 10.11.2023 ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale –Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.156/22, të datës 02.08.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale –Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.156/22, të datës 02.08.2023, nën pikën I. të dispozitivit është refuzuar në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit BPrAL “Kolegji UBT-e” Sh.p.k me seli në Prishtinë,

kundër të paditurve Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Agjencia e Akreditimit të Kosovës, me të cilën ka kërkuar që të anulohet si i kundërligjshëm vendimi nr. ref 323/19D i datës 16.01.2019 i nxjerrë nga i padituri Këshilli Shtetëror i Cilësisë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe që të detyrohen të paditurit që të aprovojnë si të bazuar kërkesën e paditësit për akreditim të programeve të reja studimore për programet BSc Psikologji, Dr. Med Mjekësi e Përgjithshme 360ECTS; BA Gjuhë Angleze 180 ECTS; BSc Infermieri (Prizren dhe Ferizaj), BSc Mami; BSc Fiziatri 180 ECTS; PhD Administrim Biznesi dhe Ekonomi 180 ECTS, PhD Arkitekturë dhe Planifikim Urban 180 ECTS dhe MSc Infermieri 120 ECTS. Ndërsa nën pikën II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që aktgjykimi i anikmuar të priset dhe çështja ti kthehet Dhomës së Shkallës së Parë në rishqyrtim dhe rivendosje, apo që i njëjti të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të aprovet në tërësi si e pa bazuar dhe kështu të detyrohen të paditurit: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë Prishtinë, si dhe Agjencia e Akreditimit të Kosovës, Prishtinë që kërkesën e paditëses për akreditim të programeve të reja studimore (nr.1507/18H) dhe atë BSc Psikologji, Dr. Med Mjekësi e Përgjithshme 360ECTS; BA Gjuhë Angleze 180 ECTS; BSc Infermieri (Prizren dhe Ferizaj), BSc Mami; BSc Fiziatri 180 ECTS; PhD Administrim Biznesi dhe Ekonomi 180 ECTS si dhe MSc Infermieri 120 ECTS, që ë procedurë të mëtejme administrative ta aprovojnë në tërësi si kërkesë të bazuar në ligj.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqit e paditura.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës secilën veç e veç dhe lidhshmërinë e tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar nr. ref 323/19D të datës 16.01.2019 të Këshilli Shtetëror i Cilësisë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, nën pikën I të dispozitivit të vendimit është refuzuar kërkesa e Kolegjit UBT (nr.1507/18H datë 31.10.2018) për riakreditim/akreditim të programeve të studimit si: Infermieru BSc 180 ECTS (dega Prizren), Shkenca të Sportit dhe Menaxhment BSc 180 ECTS; Teknologjia dhe Edukimi Profesional, BSc 180 ECTS, Administrim Biznesi dhe Ekonomi, PhD, 180 ECTS; Arkitekturë dhe Planifikim Urban, PhD, 180 ECTS; Higjienist Dentar, BSc, 180 ECTS, Infermieri, MSc, 120 ECTS, Mami, BSc, 180 ECTS; Fiziatri, BSc 180 ECTS, Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc 180 ECTS (dega Ferizaj), Inxhinieria e Qëndrueshme e Energjisë dhe Ambienti, MSc, 120 ECTS; Psikologji, BSc 180 ECTS; Mjekësi e Përgjithshme, Dr. Med, 360 ECTS; Gjuhë Angleze, BA, 180 ECTS; Menaxhment, Biznesi dhe Ekonomi, BSc, 180 ECTS (dega Prizren), dhe Infermieri, BSc, 180 ECTS (dega Ferizaj). Nën pikën II. të dispozitivit, ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e të paditurës Këshilli Shtetëror i Cilësisë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 04.07.2020 me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Dhoma e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit nr. ref 323/19D i datës 16.01.2019, të Këshilli Shtetëror i Cilësisë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, dhe pas administrimit të provave si në procesverbalin e shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Me arsyetim se Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 29 dhe 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, thënieve në padi dhe përgjigjen në padi të paditurit si dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Gjykata po ashtu shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në kuptim të nenit 22 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (UA nr. 15/2018) i cili përcakton se: *“1. Komisioni i Ankesave, do të trajtoj dhe do të vendos për ankesat e parashtruara nga institucionet e arsimit të lartë kundër vendimeve të KSHC-së. 2. Ankesa parashtrohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KSHC-së në përputhje me Ligjin mbi Procedurën Administrative. 3. Komisioni i ankesave shqyrton ankesën dhe nxjerr vendim brenda tridhjetë (30) ditësh nga data*

e dorëzimit të ankesës. 4. KSHC aprovon rregulloren e ankesave të AKA-së, e cila specifikon procedurën ankimore që zhvillon Komisioni i Ankesave. 5. Vendimi i nxjerrë lidhur me ankesën e parashtruar është përfundimtar. Ndaj këtij vendimi pala e pakënaqur mund të fillojë konfliktin administrativ përmes padisë në gjykatën kompetente. ...”. Ndër të tjera ka cek se Gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga i padituri në procedurë administrative dhe në kundërshtim me provat e administruara në këtë çështje pasi që nuk është vërtetuar se paditësi ka plotësuar kërkesat e UA nr. 15/2018 dhe Direktivës Evropiane të miratuar nga Parlamenti Evropian 2005/36, (7 shtator 2005) për Njohjen e Kualifikimeve profesionale, për akreditimin e programeve të studimit BSc Psikologji, Dr. Med. Mjekësi e Përgjithshme 360 ECTS; BA Gjuhë Angleze 180 ECTS; BSc Infermieri (Prizren dhe Ferizaj), BSc Mami; BSc Fiziatr 180 ECTS; PhD Administrim Biznesi dhe Ekonomi 180 ECTS, PhD Arkitekturë dhe Planifikim Urban 180 ECTS dhe MSc Infermieri 120 ECTS. Po ashtu Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese emrat e bartësve të programeve studimore të propozuar nga paditësi dhe kualifikimi profesional i tyre si dhe kualifikimi bartësve të programeve i përcaktuar nga i padituri në vendimin kontestues dhe përgjatë shqyrtimeve gjyqësore. Ka shtuar se Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur ka refuzuar kërkesën e paditësit për akreditimin e programeve të reja studimore për programet BSc Psikologji, Dr. Med. Mjekësi e Përgjithshme 360 ECTS; BA Gjuhë Angleze 180 ECTS; BSc Infermieri (Prizren dhe Ferizaj), BSc Mami; BSc Fiziatr 180 ECTS; PhD Administrim Biznesi dhe Ekonomi 180 ECTS, PhD Arkitekturë dhe Planifikim Urban 180 ECTS dhe MSc Infermieri 120 ECTS pasi që paditësi nuk ka plotësuar kriteret e përcaktuara në Udhëzimit Administrativ nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës dhe në Direktivën Evropiane nr. 2005/36, të miratuar nga Parlamenti Evropian (7 shtator 2005) për Njohjen e Kualifikimeve profesionale. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në kuptim të nenit 9 par.1 të UA nr. 15/2018 i cili përcakton se: “1. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë të cilat funksionojnë në Kosovë dhe ofrojnë programe të studimit që shpijnë tek marrja e një diplome akademike apo një diplome profesionale, titulli akademik, duhet të aplikojnë për akreditim në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA).” dhe nenin 10 par. 1 të UA nr. 15/2018 i cili përcakton se: “1. Procedura standarde për akreditim/ riakreditim i përfshin hapat si në vijim: 1.1. Dorëzimi i Kërkesës për akreditim (faqet e para) dhe listave të stafit akademik (Deklaratave të stafit akademik). ...”. Andaj, Dhoma e Shkallës së Parë vlerëson se i padituri i dytë ka vepruar drejtë kur ka refuzuar kërkesën e paditësit për akreditim në programin e studimit Dr. Med. Mjekësi e Përgjithshme, 360 ECTS, pasi që paditësi ka statusin juridik të Kolegjit dhe

jo të Universitetit në kuptim të nenit 10 të Ligjit për Arsimin e Lartë, ashtu që për të ofruar studime në programin e studimit Dr. Med. Mjekësi e Përgjithshme 360 ECTS, bartësi i arsimit të lartë duhet të ketë statusin e Universitetit. Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e paditësit se Direktiva Evropiane nr. 2005/36 nuk gjen zbatim në Republikën e Kosovës, pasi që gjykata vlerëson se neni 26 par. 5, nën-par. 5.2, pika 5.2.5. i UA nr. 15/2018 ka përcaktuar detyrimin për zbatim të kriterëve të direktivave të Komisionit Evropian, përveç kriterëve të përcaktuara në UA nr. 15/2018, andaj gjykata vlerëson se i padituri i dytë me të drejtë ka zbatuar këtë direktivë. Në fund, gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e paditësit se i njëjti nuk ka qenë në dijeni për ndryshimet e Udhëzimit Administrativ që ka hyrë në fuqi me datë 05.10.2018 dhe se LPPA nuk sanksionon mosdijen e palës ashtu që padituri i dytë nuk i ka dhënë mundësinë paditësit që të plotësojë aplikimin sipas ndryshimeve që janë bërë në udhëzim administrativ, por gjykata këto pretendimet i vlerësoi si të pabazuara pasi që UA nr. 15/2018 është nënshkruar nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me datë 28.09.2018 dhe në kuptim të nenit 35 të këtij UA i njëjti ka hyrë në fuqi 7 ditë pas publikimit në gazetë zyrtare, ashtu që i njëjti ka qenë në fuqi nga data 05.10.2018. Lidhur me këtë gjykata vlerëson se i padituri i dytë ka vepruar në kuptim të nenit 4 par.1 të LPPA-së i cili përcakton se: *“Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.”*. Kështu, Dhoma e Shkallës së Parë nuk gjeni rrethanë nën të cilën i padituri i dytë ka vepruar jashtë kompetencës së tij dhe në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe me rregullat e përgjithshme administrative.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Dhoma e Shkallës së Parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 29 dhe 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se Dhoma e Shkallës së Parë ka vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë gjendjen faktike në dëm të paditësit, me çka ka cenuar rëndë dispozitat e nenit 182

të LPK-së, për faktin se Dhoma e Shkallës së Parë gjatë procedurës nuk i ka zbatuar drejtë dispozitat e këtij ligji, gjë e cila për pasojë ka pasur nxjerrjen e aktgjykimit të goditur si vendim gjyqësor jo të drejtë dhe të pa qëndrueshëm. Arsyetimi i aktgjykimit me të dhëna të paqarta dhe kontradiktore, siç është rasti i aktgjykimit të ankimuar është i barasvlershëm me mungesën e plotë të arsytimit, këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi që aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurale, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit Dhoma e Shkallës së Parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket i përket pretendimeve ankimore se tek aktgjykimi i goditur ekziston vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike ngase Dhoma e Shkallës së Parë gabimisht ka vërtetuar faktet vendimtare, respektivisht faktet kyçe nuk janë vërtetuar fare, paditësi konsideron se Dhoma e Shkallës së Parë nuk është dashur që të refuzoj padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar pa hulumtuar dhe gjetur e konstatuar si dhe vërtetuar se ishte e paditura e dytë ajo e cila shumë bartësve privat të Arsimit të Larë në Republikën e Kosovës ua kishte pranuar kërkesat për akreditim të programeve të reja studimore (nr.1507/18H), dhe atë: BSc Psikologji, Dr. Med Mjekësi e Përgjithshme; 360 ECTS, BA Gjuhë Angleze, 180 ECTS; BSc Infermieri (Prizren dhe Ferizaj); BSc Mami; BSc Fiziatri 180 ECTS; Phd Administrim Biznesi dhe Ekonomi, 180 ECTS si dhe MSc Infermieri, ani pse qëndron i dëshmueshëm fakti-pa asnjë formë subjektivizmi dhe/apo rrethanash favorizuese se asnjë nga kolegjet e Arsimit të Lartë Privat në Republikën e Kosovës nuk plotësonin objektivisht më mirë kushtet si dhe kriteret adekuate për akreditim programesh të sipërme se sa pala paditëse. Kolegji këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, për faktin se Dhoma e Shkallës së Parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e tij janë të pa bazuara, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditurit të parë dhe Paditurit të dytë dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës. Kjo për faktin se paditësi nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në Udhëzmin Administrativë nr.15/2018 për Akreditimin e institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës dhe Diriktivën Evropiane të miratuar nga Parlamenti Evropian 2005/36, (7 shtator 2005) për Njohjen e Kualifikimeve profesionale. Prandaj, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë, dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Kolegji i kësaj gjykate vlerësoj të gjitha pretendimet tjera ankimore por i refuzoj si të pa bazuar për shkak se pretendimet e tilla ishin shqyrtuar edhe në procedurën gjyqësore pranë gjykatës së shakllës së parë, dhe se e njehta gjykatë ka dhën sqarime për secilën pretendim të paditësi dhe si të tilla i pranon edhe kjo gjykatë, andaj dhe vendosi që ankesën e paditësit ta refuzoj dhe ta vërtetoj aktgjykimin e ankimuar

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes Dhoma e Shkallës së Dytë gjen se ashtu siç është vepruar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë pretendimet e paditësit janë të pa bazuara sa i përket asaj se aktgjykimi është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe se bartë me vete edhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, shkelje këto të përkufizuar me nenin 184 të LPK-së. Kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë drejtë ka vendosur kur është bazuar në dispozitat e nenit 13 par .1 nën par 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 43 par.3 dhe 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit, aktgjykimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Skallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1669/23, me datë 22.04.2024

Kryetare e kolegjit,
Franciska Zhitija Ymeri